



UNIVERSITETI I EVROPËS JUGLINDORE  
УНИВЕРЗИТЕТ НА ЈУГОИСТОЧНА ЕВРОПА  
SOUTH EAST EUROPEAN UNIVERSITY

**FAKULTETI I DREJTËSISË**

**STUDIME POSTDIPLOMIKE – CIKLI I DYTË**

**Tema:**

**Krimet e luftës në territorin e RM-së gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001**

**Kandidati :**

**Hava Abazi**

**Mentori:**

**Prof.Dr.Besa Arifi**

**Tetovë, 2019**

## **Përmbatja**

<b>Hyrje.....</b>	<b>4</b>
<b>Kapitulli I.....</b>	<b>6</b>
<b>1.1 Kuptimi për krimet e luftës .....</b>	<b>6</b>
<b>1.2 Definicioni i krimeve të luftës sipas të drejtës ndërkombëtare penale .....</b>	<b>7</b>
<b>1.3 Definicioni i krimeve të luftës sipas Kodit Penal të RM-së.....</b>	<b>9</b>
<b>1.4 Aktet ndërkombëtare që parandalojnë krimet e luftës.....</b>	<b>11</b>
1.4.1 Konventat e Gjenevës të vitit 1949 .....	12
<b>1.5 Përcaktimi i krimeve të luftës sipas Statutit të Tribunalit të Hagës për ish Jugosllavinë .....</b>	<b>16</b>
<b>Kapitulli II .....</b>	<b>18</b>
<b>2.1 Krimet ndërkombëtare.....</b>	<b>18</b>
2.1.1 Kuptimi i krimeve ndërkombëtare.....	18
<b>2.2 Kategoritë e krimeve ndërkombëtare .....</b>	<b>20</b>
2.2.1 Gjenocidi.....	20
2.2.2 Krimet kundër njerëzimit.....	22
2.2.3 Krimet e luftës .....	25
<b>Kapitulli III.....</b>	<b>28</b>
<b>3.1 Veprat penale të cilat konsiderohen krime lufte .....</b>	<b>28</b>
<b>3.2 Dënimi i krimeve të luftës sipas Statutit të Gjykatës penale ndërkombëtare .....</b>	<b>29</b>
<b>Kapitulli IV .....</b>	<b>36</b>
<b>4.1 Krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001 në territorin e RM-së .....</b>	<b>36</b>
4.2.1 Rasti i Lubotenit .....	40
<b>Konkluzat dhe rekomandime .....</b>	<b>49</b>
<b>Bibliografia .....</b>	<b>52</b>



# Hyrje

Objekt studimi në këtë punim do jenë krimet e luftës të cilat janë krime ndërkombëtare, me theks të veçantë krimet e luftës të kryera në Republikën e Maqedonisë gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001.

Krimet e luftës janë të parapara në të gjitha legjislacionet penale të të gjitha shteteve dhe janë të dënueshme sipas neneve përkatëse të Kodeve Penale të shteteve të ndryshme. Në Republikën e Maqedonisë krimet e luftës janë parapa në nenin 105 të Kodit Penal dhe dënohen me minimum 5 vite burg deri në burgim të përjetshëm.

Ekziston një numër i madh i Konventave bilaterale dhe multilaterale me anë të së cilave ndalohen krimet e luftës, gjithashtu edhe në Statutet e Tribunaleve ndërkombëtare janë të parapara krimet e luftës si krime ndërkombëtare dhe krimet e tilla dënohen sipas neneve përkatëse.

Statuti i Tribunalit të Hagës për ish Jugosllavinë në nenin 2-5 i ka parapa veprat penale të cilat janë në kompetencë të Tribunalit, ku një prej këtyre veprave penale janë krimet e luftës apo krimet e rënda në kundërshtim me Konventat e Gjenevës të cilat parandalojnë krimet e luftës.

Krimet e luftës karakterizohen si vepra penale më të rënda dhe në shumicën e rasteve janë paraqitur si problematike për shkak se ka qenë shumë vështirë që të njejtat të verifikohen dhe sanksionohen.

Qëllimet e këtij hulumtimi janë të shumta, mirpo më poshtë do ti paraqes vetëm dy prej tyre, për të cilat mendoj se janë më të rëndësishmet, si:

- Veprat penale në kohë lufte janë në të shumtën e rasteve vepra pa gjurmë;
- Mos respektimi i asnjë konvente të cilat ndalojnë krimet e luftës.

Rëndësia e këtij punimi qëndron në faktin se me këtë punim do të shtohen informatat dhe analizat për krimet e kryera në Republikën e Maqedonisë gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001, siç ishin vrasjet makabre nga ana e oficerëve maqedon, trajtim mizor, shkatërim i objekteve të banimit, e shumë vepra penale të tjera të cila janë të ndëshkueshme apo të gjitha këta me një emër quhen si krime lufte dhe shkelje të Konventave të Gjenevës të vitit 1949.

Besoj që ky punim do jetë i rëndësishëm edhe për gjeneratat e ardhshme pasi që do furnizohen me material në gjuhën shqipe dhe do kenë më shumë informata për krimet e luftës që janë shkaktuar në konfliktin e armatosur të vitit 2001 në Republikën e Maqedonisë.

# Kapitulli I

## 1.1 Kuptimi për krimet e luftës

Krimet e luftës janë vepra penale të cilat kryhen në kohë lufte. Krimet e luftës janë vepra penale të cilat në shumicën e rasteve ngelen si vepra jetim, që nënkupton se në shumicën e rasteve kryesit e këtyre veprave penale ngelen pa u identifikuar dhe pa u dënuar.

Nga vetë termi “krime” nënkuptojmë se këta vepra penale bëjnë pjesë në grupin e veprave më të rënda penale, pasi që në kohë lufte gjithmonë janë kryer vrasje makabre, trajtim mizor, shkatërime dhe djegje të objekteve pa asnjë shkak si dhe një numër i madh i veprave penale të cilat do ti përmendim më poshtë, kur do flitet për llojet e veprave penale që konsiderohen si krime lufte.

Kuptimin e krimeve të luftës më së miri mund ta gjejmë duke u kthyer pas në histori, në luftërat botërore, qoftë lufta e parë apo lufta e dytë botërore, luftërat e shteteve të ish Jugosllavisë, e deri te luftërat e shkaktuara në shtetet arabe ku për fat të keq vrasja e civilëve dhe shkatërimi i objekteve civile dhe institucioneve arsimore, objekteve fetare, etj. nuk ka të ndalur deri sa të mos mbetet asgjë. Në luftërat e shkaktuara në ish Jugosllavi, si krim më të rëndë mund të llogarisim vrasjen e 8000 burave në Srebrenicë, e cila u emërua si Gjenocidi i Srebrenicës. Krim lufte konsiderohet edhe “deklarimi se nuk do të ketë mëshirë”, që për fat të keq kjo ndodhi në luftën kundë Republikë së Kosovës nga ana e ushtrisë serbe.

## **1.2 Definicioni i krimeve të luftës sipas të drejtës ndërkombëtare penale**

Krimet e luftës janë shkelje serioze të rregullave ndërkombëtare që burojnë nga traktatet ndërkombëtare ose ligji ndërkombëtar humanitar në konfliktet e armatosura.<sup>1</sup> Krimet e luftës nuk janë të definuara në një dokument unik ligjor, megjithatë sipas konventave të Gjenevës janë përcaktuar se cilat krime konsiderohen krime të luftës. Sipas konventave të Gjenevës si krime lufte konsiderohen këto vepra penale kundër personave të mbrojtur apo vlerave të mbrojtura të cilat janë:

- Tortura dhe sjellja jonjerëzore, përfshirë edhe eksperimentet biologjike ndaj personit të mbrojtur, robërve të mbrojtur të luftës apo personit civil të mbrojtur;
- Shkaktimi i qëllimshëm i mundimeve të mëdha apo lëndimeve të rënda trupore apo dëmtimet e rënda të shëndetit;
- Shkatërrimi dhe përvetësimi i kundërligjshëm dhe arbitrar i pasurisë së huaj, i cili nuk është i arsyeshëm për nevojat ushtarake;
- Detyrimi i personit të mbrojtur që të shërbejë në formacionet ushtarake të armikut;
- Privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të ndershëm dhe objektiv ( të paanshëm) i garantuar me konventa;
- Shpërngulja e kundërligjshme, kolonizimi apo kufizimi i lirisë së personave të mbrojtur;
- Marrja e pengjeve;

---

<sup>1</sup> Jola Xhafo, E drejta penale ndërkombëtare, fq 69, Tiranë 2012

- Shpërngulja e popullsisë civile nga vendbanimet e okupuara brenda shtetit apo jashtë shtetit;
- Prolongimi (shtyrja zvaritja) i padrejtë i kthimit të robërve të luftës në shtetin e tyre;
- Imponimi i aparteidit apo praktikës tjetër nënçmuese, që bazohet në diskriminim racor;
- Sulmi në monumentet historike, në vepra artistike apo vende të tjera fetare të cilat vërehen qartë dhe të cilat paraqesin trashigimi kulturore dhe shpirtërore të popullit, që gëzojnë mbrojtje të posaçme.<sup>2</sup>

Kryes i të gjithave krimeve të luftës mundë të jetë çdo person i cili është penalisht përgjegjës dhe i cili duhet të dënohet, dhe gjithashtu mundë të dënohet edhe personi që ka planifikuar dhe ka urdhëruar kryerjen e këtyre krimeve, shumica e këtyre krimeve kryhen nga persona ushtarake, pjesëtarë të policisë,apo nga personat me pozita të larta.

Gjithashtu pa marrë parasysh nëse kryesi është kryetar shteti, pjesë e qeverisë apo ndonjë zyrtarë tjetër i shtetit pozita e tij në asnjë mënyrë nuk e liron kryesin nga përgjegjësia penale ai gjithashtu duhet të dënohet me dënimin e paraparë sikurse edhe të mos ishte person me ndonjë pozitë zyrtare.

Ndërsa sa i përket fajësis këto vepra mund të kryhen vetëm me dashje, ndërsa krahas dashjes duhet të ekzistojë edhe qëllimi i caktuar.

---

<sup>2</sup>[https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1\\_rul\\_rule156](https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1_rul_rule156)



Këto krime kryhen gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit. Gjithashtu duhet të përmendet edhe tentativa për kryerjen e krimeve të luftës që në këtë rast gjithashtu ndëshkohet.

Pra siç shihet nga kjo që thamë më sipër del definicioni se krimet e luftës janë vepra penale ndërkombëtare nga më të rëndat, të cilat kryhen në kohë lufte nga persona të ndryshëm, ndaj të cilave janë paraparë dënime më rigorozë, të cilat janë të pa tolerueshme si dhe asnjë kryes nuk mundë të shpëtojë nga dënimi i paraparë pavarësisht pozitës së tij, apo ti merit si rethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit pozita e tij.

Krimet e luftës pas Luftës së Dytë Botërore janë të parapara me rregulla dhe norma juridike kryesisht në konventat ndërkombëtare të cilat janë të karakterit obligativ, ndërsa me herët ishin përcaktuar rregullat të cilat duhet të respektohen nga palët ndërluftuese me akte ndërkombëtare të cilat do të cekim në vazhdim të këtij punimi.

### **1.3 Definicioni i krimeve të luftës sipas Kodit Penal të RM-së**

Në Kodin Penal të RM-së janë të përmendura krimet e luftës kundër popullatës civile, krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve, krimet e luftës kundër roberve të luftës dhe përdorimi i mjeteve të palejuara të luftës.

**Krimet e luftës kundër popullatës civile**-sipas këtij neni ai person i cili gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo gjatë okupimit urdhëron që të kryhet sulm ndaj popullatës civile, ndaj personave civil, apo ndaj personave të pa aftë për luftë që si pasojë do të kenë vdekjen, lëndime të rënda trupore, apo shkatërim të shëndetit duke i shkelur rregullat e së drejtës ndërkombëtare penale, gjithashtu ai

person i cili do të kryej veprime jonjerëzore, mundime të ndryshme, eksperimente biologjike apo mjekësore, transplatim të organeve, prostitucion, përdhunim, shtatzani të dhunshme etj për kryerjen e ndonjëres nga këto veprat e përmendura do të dënohet me së paku dhjetë vjet burg apo me burg të përjetshëm.

**Krimet e luftës kundër të plagosurve dhe të sëmururve-** personat të cilët gjatë kohës së luftës apo konfliktit të armatosur do të shkelin rregullat e së drejtës ndërkombëtare penale duke urdhëruar që të plagosurit apo të sëmururit të vriten, të keqtrajtohen, të mundohen apo të kryejnë eksperimente përfshirë ato biologjike, mjekësore apo shkencore dhe nëse kryhet transplatimi i organeve të tyre do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim apo me burgë të përjetshëm.

**Krimet e luftës kundër robërve të luftës**—Pra edhe ndaj robërve të luftës nëse kryhet vrasje, mundime apo veprime jonjerëzore të cilat janë në kundërshtim me të drejtën penale ndërkombëtare, apo nëse privohen nga e drejta e gjyqimit të drejtë dhe të paanshëm dhe nëse kryhet dënimi pa aktgjykim i cili është marë më parë nga ana e gjyqit të themeluar sipas ligjit pra aai i cili do të kryej ndonjë nga veprat e lartpërmendura do të dënohet me së paku dhjetë vjet burg apo me burgë të përjetshëm.

**Përdorimi i mjeteve të palejuara të luftës-** ai i cili në kohë të luftës apo konfliktit të armatosur do të urdhërojë të përdoren helme apo armë helmuese, gazra helmuese, gazra për zënien e frymës apo lloje tjera të gazrave apo lëngje, materie apo vegla tjera të ngjajshme, mina shkelëse kundër këmbësorisë, plumba të cilat lehtëmundë të shpërndahen në trupin e njeriut, si plumba me gëzhojë të rëndë armë, predha, materiale apo mënyrë tjeter e luftimit, të cilat sipas natyrës shkaktojnë mundime apo lëndime të panevojshme, do të dënohet me së paku një vjet burgim, ndërsa për shkak të ndonjëres nga këto vepra të kryera do të kenë vdekur më tepër persona

atëherë kryesi do të dënohet me së paku dhjetë vjet burgim ose me burgë të përjetshëm.

Pra siç shihet Kodi Penal i RM-së të gjitha llojet e krimeve të luftës i dënon prej më së paku dhjetë vjetë burgim dhe dënimi maksimal, i cili është dënimi me burg të përjetshëm, pra të gjitha llojet e krimeve të luftës të kryera gjatë konfliktit të armatosur ose okupimit karakteristike është se të gjitha ato dënohen me dënime të njejta.

#### **1.4 Aktet ndërkombëtare që parandalojnë krimet e luftës**

Angazhimi i bashkësisë ndërkombëtare për nxjerrjen e rregullave dhe normave juridike me anë të së cilave u përcaktuan limitet që duhet të respektohen nga palët ndërluftuese në historinë e njerzimit janë të hershme, por në formë më të sistemuar dhe të kodifikuar ishin më produktive nga fundi i shekullit 19 e këndej, veçmas duhet të cekën këto akte ndërkombëtare:

- rregullat e Hagës, të cilat i dedikohen luftës në ajër të vitit 1923;
- konventat ndërkombëtare, të cilat u referohen disa armëve të caktuara;
- konventat e Gjenevës të vitit 1864, 1906 dhe 1929.<sup>3</sup>

---

<sup>3</sup> Ismet Salihu, E drejta penale ndërkombëtare, fq 318, Prishtinë 2005

## 1.4.1 Konventat e Gjenevës të vitit 1949

Pas Luftës së Dytë Botërore u bë kodifikimi i krimeve të luftës sidomos me këto katër konventa të Gjenevës për humanizimin e luftës të vitit 1949.

Këto konventa të Gjenevës të vitit 1949 ishin:

1. **Konventa e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurëve të forcave të armatosura në luftë (Konventa e Gjenevës nr.I);**
2. **Konventa e Gjenevës për përmirësimin e fatit të të plagosurve, të sëmurve dhe anijeve të përmbytura të forcave të armatosura detare (Konventa e Gjenevës nr II);**
3. **Konventa e Gjenevës lidhur me sjelljen ndaj robërve të luftës (Konventa e Gjenevës nr III)**
4. **Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës (Konventa e Gjenevës nr IV).<sup>4</sup>**

Lidhur me këto Konventa të Gjenevës të vitit 1949 janë shumë të rëndësishme edhe dy Protokolle plotësuese të këtyre konventave të cilat u nxorën në vitin 1977:

-**Protokolli I** cili i referohet mbrojtjes së viktimave të konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe

-**Protokolli II** I cili u referohet konflikteve të armatosura të brendshme, brenda një shteti.<sup>5</sup>

---

<sup>4</sup>[http://www.punetegashtme.gov.al/files/userfiles/Konventat\\_e\\_Gjeneves.pdf](http://www.punetegashtme.gov.al/files/userfiles/Konventat_e_Gjeneves.pdf)

<sup>5</sup><http://www.infocip.org/al/?p=6641>

## **Krimet e rënda në kundërshtim me Konventat e Gjenevës**

Konventat e Gjenevës përbëhen nga katër traktate dhe tre protokolle të tjera, që vendosin standardet e së drejtës ndërkombëtare për trajtime humanitare të luftës. Termi njëjës Konventa e Gjenevës zakonisht tregon marrëveshjet e vitit 1949, të negociuara si pasojë e Luftës së Dytë Botërore (1939-45), i cili i ka përvetësuar kushtet e tre traktateve të para (1864, 1906, 1929). Konventat e Gjenevës në përgjithësi përcaktojnë të drejtat themelore të të burgosurve të luftës (civilëve dhe personelit ushtarak); mbrojtje për të plagosurit e luftës dhe mbrojtje për civilët në dhe rreth një-zone lufte. Traktatet e vitit 1949 u ratifikuan në tërësi ose me rezerva, nga 196 vende.<sup>6</sup>

Shkelje e rëndë e Konventave të Gjenevës sipas nenit 118, konsiderohet:

- 1) vrasja me qëllim,
- 2) tortura ose trajtimi çnjerëzor, duke përfshirë eksperimentet biologjike,
- 3) shkaktimi i qëllimshëm i vuajtjeve të mëdha ose i dëmtimeve të rënda trupore,
- 4) shkatërimi masiv dhe marrja e pajustificushme e pronës për nevojat ushtarake të kryera në mënyrë të paligjshme dhe me dashje,
- 5) detyrimi i një robi lufte ose një personi tjetër për të shërbyer në forcat e armikut,
- 6) privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të drejtë dhe të rregullt për robërit e luftës apo personat e tjerë të mbrojtur,
- 7) detyrimi i paligjshëm, transferimi ose mbyllja e paligjshme,

---

<sup>6</sup>Shtetet Palë, Nënshkruesit e Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, E drejta ndërkombëtare humanitare, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Marrë 22-01-2007(wikipedia) fq.2

## 8) marrja e pengjeve.<sup>7</sup>

Sipas konventave të sipërpërmendura të Gjenevës dhe të Protokollit I si krime të luftës konsiderohen këto vepra penale kundër personave të mbrojtur apo vlerave të mbrojtura:

- Tortura dhe sjellja jonjerëzore,perfshirë edhe eksperimentet biologjike ndaj personit të mbrojtur, robërve të mbrojtur të luftës apo personit civil të mbrojtur;
- Shkaktimi i qëllimshëm i mundimeve të mëdha apo lëndimeve të rënda trupore apo dëmtimet e rënda të shëndetit;
- Shkatërrimi dhe përvetësimi i kundërligjshëm dhe arbitrar i pasurisë së huaj, i cili nuk është i arsyeshëm për nevojat ushtarake;
- Detyrimi i personit të mbrojtur që të shërbejë në formacionet ushtarake të armikut;
- Privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të ndershëm dhe objektiv ( të paanshëm) i garantuar me konventa;
- Shpërngulja e kundërligjshme,kolonizimi apo kufizimi i lirisë së personave të mbrojtur;
- Marrja e pengjeve;
- Shpërngulja e popullsisë civile nga vendbanimet e okupuara brenda shtetit apo jashtë shtetit;
- Prolongimi (shtyrja zvaritja) i padrejtë i kthimit të robërve të luftës në shtetin e tyre;

---

<sup>7</sup> wipo.int, Konventa e Gjenevës në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë Lufte, 12 gusht, 1949, (wikipedia), fq.2

- Imponimi i aparteidit apo praktikës tjetër nënçmuese, që bazohet në diskriminim racor;
- Sulmi në monumentet historike, në vepra artistike apo vende të tjera fetare të cilat vërehen qartë dhe të cilat paraqesin trashigimi kulturore dhe shpirtërore të popullit, që gëzojnë mbrojtje të posaçme.<sup>8</sup>

Sipas Konventës së Hagës lidhur me ligjet dhe zakonet e luftës të vitit 1907 dhe Rregullores së saj gjithashtu të vitit 1907 krime të luftës konsiderohen edhe:

**a) Mënyra e ndaluar e luftës dhe**

**b) Mjetet e ndaluara të luftës**

Si mënyra të ndaluara të luftës konsiderohen këto vepra të cilat shkaktojnë vdekjen apo lëndime të rënda trupore, ose dëmtime të rënda të shëndetit:

- sulmi në vendbanime civile apo ndaj personave të caktuar civilë;
- sulmi pa i zgjedhur caqet apo sulmi ndaj objekteve apo instalimeve të cilat për nga natyra e tyre shkaktojnë rreziqe, duke e ditur se sulmi i tillë shkaktonë humbjen e jetës të shumë njerëzve, dëmtime të popullsisë civile apo që shkakton dëme së tepërmi në objekte civile;
- sulmi në territore të demilitarizuara apo territore të pambrojtura;
- sulmi ndaj personave, të cilët janë jashtë luftës;
- përdorimi perfid i shenjave të dukshme të Kryqit të Kuq, gjysmëhënës apo të shenjave të tjera që janë të mbrojtura me të drejtën ndërkombëtare

Ndërsa si mjete të ndaluara të luftës, sipas konventave të përmendura konsiderohet përdorimi i këtyre armëve:

---

<sup>8</sup> Ismet Salihu, E drejta penale ndërkombëtare, fq 319, Prishtinë 2005

- Të cilat shkaktojnë mundime të panevojshme
- Të cilat për shkak të pasaktësisë apo efektit të tyre i godasin si pjesëtarët e forcave të armatosura ashtu edhe personat civilë
- Përdorimi i armëve të tilla efekti i të cilave nuk mundë të kontrollohet në kohë dhe hapësirë.<sup>9</sup>

## **1.5 Përcaktimi i krimeve të luftës sipas Statutit të Tribunalit të Hagës për ish Jugosllavinë**

Në nenin 8 të Statutit janë të parapara **krimet e luftës**. Neni 8 përcakton krimet e luftës në varësi të faktit nëse një konflikt i armatosur është ose ndërkombëtarë (që zakonisht do të thotë se luftohet në mes shteteve) ose jo-ndërkombëtarë (që në përgjithësi do të thotë se ajo është luftë mes aktorëve jo-shtetërorë, të tilla si grupe rebele). Në total janë 74 krime lufte të renditura në nenin 8. Krimet më të rënda, megjithatë, janë ato që përbëjnë shkelje të rënda të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, që zbatohen vetëm për konfliktet ndërkombëtare dhe shkelje të rënda të Nenit 3 që janë të përbashkëta për Konventat e Gjenevës të vitit 1949, të cilat zbatohen për konfliktet.<sup>10</sup>

---

<sup>9</sup> Ibidem, fq 321

<sup>10</sup> Elementet e krimeve, Gjykata penale ndërkombëtare, 2011. Publikuar nga Gjykata penale ndërkombëtare ISBN Nr 92-9227-232-2, fq 5





## **Kapitulli II**

### **2.1 Krimet ndërkombëtare**

#### **2.1.1 Kuptimi i krimeve ndërkombëtare**

Krimet ndërkombëtare nuk janë të definuara në mënyrë precize mirpo mundë të thuhet se ato paraqesin shkelje të të mirave dhe vlerave ndërkombëtare.

Sipas të drejtës penale ndërkombëtare përdoret koncepti se në kuptimin material veprat penale ndërkombëtare paraqesin shkelje të të mirave dhe të vlerave të rëndësishme ndërkombëtare. Në epiqendër të këtyre veprave penale, gjendet korpusi I të drejtave universal të njeriut.

Përkufizimi i këtillë është më tepër i karakterit sociologjik dhe kriminologjik, andaj aspekti juridik-penal i veprave penale ndërkombëtare e shtronë domosdoshmërinë e përcaktimit të këtij nocion edhe në kuptimin formal, i cili konsiston në faktin se këto vepra duhet të jenë të ndaluara edhe me norma juridike.<sup>11</sup>

Sipas autores Jola Xhafo e cila thot se pavarësisht nga mungesa e përkufizimit të krimeve ndërkombëtare mundë të cekim disa karakteristika të përbashkëta të krimeve ndërkombëtare sic janë:

- Krimet ndërkombëtare janë shkelje të rregullave të parashikuara në instrumentet ndërkombëtare si konventa, traktate, apo statute. Ky tipar përputhet plotësisht me parimin e ligjshmërisë sipas të cilit vepra penale duhet të jetë e parashikuar në ligj.

---

<sup>11</sup> Ismet Salihu, E drejta penale ndërkombëtare, fq 306, Prishtinë 2005

- Këto vlera kanë për qëllim të mbrojnë vlera të konsideruara të rëndësishme nga gjithë bashkësia ndërkombëtare në themel të të cilave qëndron korpusi I të drejtave themelore të njeriut.
- Mbizotron pra një interes universal I gjithë shoqërisë në dënimin e këtyre krimeve. Autorët e tyre parimisht mund të ndiqen dhe ndëshkohen nga cdo shtet pavarësisht nga lidhja territorial apo e kombësisë që mund të ekzistojë me autorin ose viktimën.
- Krimet ndërkombëtare janë rezultat I praktikave shtetërore e për pasojë subjekte të tyre janë kryesisht subjekte të posacme si komandantë ushtarak, zyrtarë shtetërore ose persona të urdhëruar apo inkurajuar prej tyre.<sup>12</sup>
- Në përputhje me rregullat e së drejtës penale ndërkombëtare, gjykohen si nga gjykatat e shteteve, ashtu edhe nga gjykatat penale ndërkombëtare.

Pra sic shihet edhe pse nuk ekziston një definicion I saktë apo preciz i cili do të definonte në mënyrë precise krimet ndërkombëtare shum autorë janë munduar që të shkruajnë disa karakteristika të përbashkëta të krimeve ndërkombëtare të cilat karakteristika I bëjnë këto krime që të dallohen nga krimet tjera, të cilat krime nga pasha e tyre janë apo paraqiten si krime më të lehta në krahasim më këto krime që konsiderohen si krime më të rënda.

---

<sup>12</sup> Jola Xhafo, E drejta penale ndërkombëtare, fq 49, Tiranë 2012

## 2.2 Kategoritë e krimeve ndërkombëtare

Veprat penale ndërkombëtare disa autorë i ndajnë në dy kategori të cilat janë: vepra penale ndërkombëtare në kuptimin e ngushtë (**stricto sensu**) dhe vepra penale ndërkombëtare në kuptimin e gjerë (**largo sensu**).

Si vepra penale ndërkombëtare në kuptimin e ngushtë apo stricto sensu konsiderohen vetëm ato vepra me të cilat sulmohen vlerat themelore të bashkësisë ndërkombëtare sic janë: krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit, gjenocidi, lufta agresive dhe shkelja e zakoneve dhe dokeve të luftës.

Ndërsa në grupin e veprave ndërkombëtare në kuptimin e gjerë apo largo sensu konsiderohen p.sh.tortura, prodhimi dhe tregtia me narkotikë, trafikimi me njerëz, tregtiat me publikime të pamoralshme, falsifikimi I parasë dhe shenjave me vlerë, larja e parasë etj<sup>13</sup>.

### 2.2.1 Gjenocidi

Fjala gjenocid rrjedh nga fjala greke genos që ka domethënien e racës, gjinisë apo fisit dhe fjalës latine occidere që domethënë për të vrrarë, për të zhdukur apo për të asgjësuar.

Gjenocid konsiderohet vepra penale e cila kryhet me qëllim të zhdukjes së tërësishme apo të pjesërishme të një grupi racor, etnik, fetar apo nacional.

---

<sup>13</sup> Jola Xhafo, E drejta penale ndërkombëtare, fq 50, Tiranë 2012

Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara me 9 dhjetor të vitit 1948 ka aprovuar **Konventën mbi parandalimin dhe ndëshkimin e krimit të gjenocidit**. Në nenin 2 të kësaj Konvente thuhet se si krime të gjenocidit që kryhen me qëllim të zhdukjes së tërësishme apo të pjesërishme të grupit nacional, etnik, racor apo fetar konsiderohen këto vepra:

1. Vrasja e anëtarit të grupit;
2. Shkaktimi i lëndimeve të rënda fizike apo psiqike antëtarëve të grupit;
3. Vënia e qëllimshme e grupit në kushtë të atilla të jetës të cilat shpinjë në shfarosje të plotë apo të pjesërishme fizike;
4. Vënien e masave me qëllim që të pengohen lindjet brenda grupit;<sup>14</sup>

Kryes i krimit të gjenocidit konsiderohet cdo person që urdhëron kryerjen e këtij krimi, si dhe ai që e kryen.

Veprimi i kryerjes- veprimet e kryerjes së këtij krimi konsistojnë në dëmtimin apo rrezikimin e integritetit biopsiçik të anëtarëve të grupit.

Objekti mbrojtës-objekti mbrojtës nga krimi i gjenocidit është e drejta që të ekzistojnë, të jetojnë grupet e caktuara nacionale, etnike, racore apo fetare.

Forma e fajit-për tu konsideruar se është kryer krimi i gjenocidit, gjykata kahash dashjes duhet të konstatojë se ky lloj krimi është kryer me qëllim, që tërësishtë apo pjesërishtë të asgjësohet grupi i caktuar nacional, etnik, racor apo fetar.

Karakteristika e gjenocidit janë se krimi i gjenocidit mundë të kryhet gjatë kohës së luftës, gjatë kohës së okupimit apo gjatë kohës së paqes, mirpo në të shumtën e rasteve gjenocidi kryhet gjatë kohës së luftës dhe okupimit.

---

<sup>14</sup> Ilias Bantekas&Susan Nash, International criminal law, pg 141, Third edition

Në historinë e njerëzimit janë të njohura disa gjenocide, mirpo ne do ti cekim vetëm disa prej tyre të cilat janë: gjenocidi në Ruanda, gjenocidi në Kamboxhia, gjenocidi në Srebrenicë etj. Kryesit e këtyre gjenocideve disa janë dënuar sic ishte rasti i gjenocidit në Srebrenicë, ku Radovan Karaxhic u dënua me 40 vjet burgim, e disa për fat të keq nuk mundën që të dënohen, sic ishte rasti i kryesit të gjenocidit në Kamboxhia Pol Potit i cili nuk ariti që të marrë dënimin për këtë vepër penale por vdiq nga ataku në zemër. Gjenocidi pra konsiderohet si një nga veprat më të rënda e cila bën pjesë në krimet ndërkombëtare ku padyshim se kryesit e tyre duhet të dënohen duke marrë dënimin e merituar, dhe pa marrë parasysh se personi kryerës i gjenocidit është kryetar shteti, zyrtarë i lartë etj, pa dyshim se pozita e tij nuk e largon nga përgjegjësia për ndëshkimin e kësaj vepre të rëndë, dhe gjithashtu për këtë vepër nuk lejohet as mundësia e parashkrimit të kësaj vepre dhe ekzekutimit të sanksionit, gjithashtu kjo vepër nuk konsiderohet edhe si vepër politike.

Gjenocidi si vepër penale ndërkombëtare është gjithashtu edhe në kompetencë të gjykatës ndërkombëtare penale. Neni 6 i Statutit të gjykatës e ka marrë përkufizimin e gjenocidit nga Konventa për parandalimin dhe ndëshkimin e gjenocidit të vitit 1948.

### **2.2.2 Krimet kundër njerëzimit**

Ndryshe nga krimet e luftës, krimet kundër njerëzimit mund të kryhen në kohë paqeje apo lufte. Ata nuk janë ngjarje të izoluara apo sporadike, por janë pjesë ose e një politike qeveritare ose pjesë e një praktike të gjërë e mizorive e toleruar nga një qeveri apo autoritet. Si krime kundër njerëzimit konsiderohen: vrasja; masakrat; dehumanizimi; shfarosjet; eksperimentimi njerëzor; dënimet

jashtëgjyqësore; zhdukjet me forcë; përdorimi ushtarak i fëmijëve; rrëmbimet; burgimi i padrejtë; skllavërimi; kanibalizëm, torturë; përdhunimi; përndjekje politike, racore, ose fetare; dhe veprime të tjera çnjerëzore, në qoftë se ata janë pjesë e një praktike të gjerë ose sistematik.<sup>15</sup>

Krimet kundër njerëzimit gjithashtu janë vepra penale ndërkombëtare ku nocioni i krimeve kundër njerëzimit për herë të parë është përcaktuar në Statutin e Gjykatës Penale Ushtarake të Nurembergut, ku si krime kundër njerëzimit janë konsideruar këto vepra penale: vrasjet, shfarosja, skllavërimi, deportimi, dhe veprimet e tjera çnjerëzore të kryera ndaj popullsisë civile, para ose gjatë kohës së luftës, apo përndjekja në baza politike, racore apo fetare, pa marrë parasysh se me kryerjen e tyre a shkelet ligji I shtetit në të cilin janë kryer krimet.

Statuti i Tribunalit të Hagës dhe Statuti i Gjykatës Penale Ndërkombëtare të Përhershme e kanë akceptuar të njëjtin nocion, miro këtë nocion e kanë zgjeruar duke shtuar se këto krime konsiderohen se kryhen nëse janë pjesë e sulmi të gjërë apo sistematik të drejtuar kundër popullsisë civile, pa marrë parasysh nëse këto krime kryhen gjatë kohës së luftës apo gjatë kohës së paqes.<sup>16</sup>

Pra si krime kundër njerëzimit konsiderohen sulmet e gjëra sistematike të drejtuara kundër popullatës civile si:

- Vrasja;
- Shfarosja;
- Skllavërimi;

---

<sup>15</sup> Margaret M. DeGuzman, *Krime Kundër Njerëzimit*, Studim mbi të Drejtën Penale Ndërkombëtare, Doracak fq.25, edituar nga, Edgar Elgar Publishing 2011

<sup>16</sup> Jola Xhafo, *E drejta penale ndërkombëtare*, fq 59, Tiranë 2012

- Deportimi ose transferimi i dhunshëm i popullsisë
- Burgosja ose privimi tjetër serioz nga liria në kundërshtim me rregullat themelore të së drejtës ndërkombëtare;
- Tortura;
- Dhunim, skllavërim seksual, prostitucioni i detyruar, shtatzënia me dhunë, sterilizimi i detyruar apo cdo formë tjetër e dhunës seksuale e krahasueshme me këto;
- Persekupim të një grup të indentifikueshëm apo bashkësi për arsye politike, racore, kombëtare, etnike, kulturore, apo fetare;
- Zhdukja e detyruar e personave;
- Krimin e aparteidit;<sup>17</sup>
- Veprat e tjera cnjerëzore të karakterit të ngjashëm që shkaktojnë qëllimisht vuajtje të mëdha, apo lëndime serioze të trupit apo të shëndetit fizik ose mendor.

Kryes i këtyre veprave konsiderohet cdo person i cili urdhëron kryerjen e një nga veprat e përcaktuara më lartë, si dhe cdo person i cili i kryen këto vepra. Ndërsa për sa i përket formës së fajit kjo vepër penale mundë të kryhet vetëm me dashje, zakonishtë me dashje direkte, por mundë të kryhet edhe me dashje eventuale.

Objekt i mbrojtës së krimeve kundër njerëzimit është popullsia civile.

Ndërsa sa i përket dënimeve, dënimi i paraparë për të gjitha llojet e krimeve kundër njerëzimit është paraparë dënimi më burgim prej pesë deri në njëzet vjet apo dënimi me burgim afatgjatë prej njëzet e një deri në dyzet vjet.

---

<sup>17</sup> Kriangsak Kittichaisare, International criminal law, pg102, Oxford



### 2.2.3 Krimet e luftës

Krimet e luftës janë shkelje serioze të rregullave ndërkombëtare që burojnë nga traktatet ndërkombëtare ose ligji ndërkombëtar humanitar në konfliktet e armatosura<sup>18</sup>. Në fillim të shekullit njëzet u shfaq koncepti për krimet e luftës kur u bë kodifikimi i së drejtës ndërkombëtare zakonore e cila ishte e zbatueshme për luftë midis shteteve. Krimet e luftës nuk janë të definuara në një dokument unik ligjor, mirpo edhe pse nuk ka ndonjë dokument që i definon ato saktë, sipas konventave të Gjenevës janë përcaktuar se cilat krime konsiderohen krime të luftës. Sipas konventave të Gjenevës si krime lufte konsiderohen këto vepra penale kundër personave të mbrojtur apo vlerave të mbrojtura të cilat:

- Tortura dhe sjellja jonjerëzore, përfshirë edhe eksperimentet biologjike ndaj personit të mbrojtur, robërve të mbrojtur të luftës apo personit civil të mbrojtur;
- Shkaktimi i qëllimshëm i mundimeve të mëdha apo lëndimeve të rënda trupore apo dëmtimet e rënda të shëndetit;
- Shkatërrimi dhe përvetësimi i kundërligjshëm dhe arbitrar i pasurisë së huaj, i cili nuk është i arsyeshëm për nevojat ushtarake;
- Detyrimi i personit të mbrojtur që të shërbejë në formacionet ushtarake të armikut;
- Privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të ndershëm dhe objektiv ( të paanshëm) i garantuar me konventa;

---

<sup>18</sup> Jola Xhafo, E drejta penale ndërkombëtare, fq 69, Tiranë 2012

- Shpërngulja e kundërligjshme, kolonizimi apo kufizimi i lirisë së personave të mbrojtur;
- Marrja e pengjeve;
- Shpërngulja e popullsisë civile nga vendbanimet e okupuara brenda shtetit apo jashtë shtetit;
- Prolongimi (shtyrja zvaritja) i padrejtë i kthimit të robërve të luftës në shtetin e tyre;
- Imponimi i aparteidit apo praktikës tjetër nënçmuese, që bazohet në diskriminim racor;
- Sulmi në monumentet historike, në vepra artistike apo vende të tjera fetare të cilat vërehen qartë dhe të cilat paraqesin trashigimi kulturore dhe shpirtërore të popullit, që gëzojnë mbrojtje të posaçme.<sup>19</sup>

Krimet e luftës mundë të klasifikohen si krime lufte të kryera gjatë konflikteve të armatosura ndërkombëtare dhe si krime lufte të kryera gjatë konfliktit të mbrendshëm të armatosur.<sup>20</sup>

Kryes i të gjithave krimeve të luftës mundë të jetë çdo person i cili është penalisht përgjegjës dhe i cili duhet të dënohet, dhe gjithashtu mundë të dënohet edhe personi që ka planifikuar dhe ka urdhëruar kryerjen e këtyre krimeve, shumica e këtyre krimeve kryhen nga persona ushtarake, pjesëtarë të policisë,apo nga personat me pozita të larta.

Gjithashtu pa marrë parasysh nëse kryesi është kryetar shteti, pjesë e qeverisë apo ndonjë zyrtarë tjetër i shtetit pozita e tij në asnjë mënyrë nuk e liron kryesin nga përgjegjësia penale ai gjithashtu duhet të dënohet me

<sup>19</sup>[https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1\\_rul\\_rule156](https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1_rul_rule156)

<sup>20</sup> Antonio Cassese, International criminal law, pg54, Oxford

dënimin e paraparë sikurse edhe të mos ishte person me ndonjë pozitë zyrtare.

Ndërsa sa i përket fajësis këto vepra mund të kryhen vetëm me dashje, ndërsa krahat dashjes duhet të ekzistojë edhe qëllimi i caktuar.

Këto krime kryhen gjatë kohës së luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit. Gjithashtu duhet të përmendet edhe tentativa për kryerjen e krimeve të luftës që në këtë rast gjithashtu ndëshkohet.

Pra siç shihet nga kjo që thamë më sipër del definicioni se krimet e luftës janë vepra penale ndërkombëtare nga më të rëndat, të cilat kryhen në kohë lufte nga persona të ndryshëm, ndaj të cilave janë paraparë dënime më rigorozë, të cilat janë të pa tolerueshme si dhe asnjë kryes nuk mundë te shpëtojë nga dënimi i paraparë pavarësisht pozitës së tij, apo ti meret si rethanë lehtësuese gjatë matjes së dënimit pozita e tij.

Krimet e luftës pas Luftës së Dytë Botërore janë të parapara me rregulla dhe norma juridike kryesisht në konventat ndërkombëtare të cilat janë të karakterit obligativ,ndërsa me herët ishin përcaktuar rregullat të cilat duhet të respektohen nga palët ndërluftuese me akte ndërkombëtare të cilat do ti cekim më vazhdim të këtij punimi.

## Kapitulli III

### 3.1 Veprat penale të cilat konsiderohen krime lufte

Pra, siç e cekëm edhe më lartë krimet e luftës janë vepra penale ndërkombëtare të kategorisë më të rëndë, të cilat kryhen në kohë lufte, dhe kryesit e këtyre krimeve dënohen me dënime më të ashpra apo më të rënda, në krahasim me veprat tjera penale të cilat janë më të lehta.

Krim i luftës konsiderohet një ndër shkeljet më të rënda të ligjeve dhe zakoneve të cilat janë të zbatueshme në konfliktet e armatosura, e cila shkelje con në përgjegjësi penale individuale sipas ligjit ndërkombëtar.<sup>21</sup>

Edhe pse në ndonjë rast kur kryhen këto krime është shumë e vështirë që të identifikohet kryesi i këtyre krimeve dhe si pasojë e kësaj kjo vepër e rëndë penale ngelet jetim dhe kryesu ngelet pa u dënuar. Megjithatë në qoftë se zbulohet kryesi i kësaj veprë të rëndë atëherë nuk do meret parasysh pozita e tij që e ka në shtetin e tij, ai asesi nuk ngelet pa u dënuar, që d.m.th. se pozita e tij nuk e liron nga përgjegjësia penale.

Pra si krime të luftës konsiderohen: tortura dhe sjellja jonjerëzore, eksperimentet biologjike të kryera tek personat, shkaktimi i qëllimshëm i mundimeve të mëdha trupore, dhe lëndimeve të rënda trupore, apo dëmtime të shëndetit, shkatërrimi dhe përvetësimi i kundërligjshëm i pasurisë së huaj, i cili nuk është i arsyeshëm për nevojat ushtarake, detyrimi i personit të mbrojtur që të shërbejë në formacionet

---

<sup>21</sup> Robert Cryer, Hakan Friman, Darryl Robinson, Elizabeth Wilmschurst, International criminal law, pg267, Second Edition

ushtarake të armikut, privimi i qëllimshëm i të drejtës për gjykim të ndershëm dhe objektiv ( të paanshëm) i garantuar me konventa, shpërngulja e kundërligjshme, kolonizimi apo kufizimi i lirisë së personave të mbrojtur, marrja e pengjeve, shpërngulja e popullsisë civile nga vendbanimet e okupuara brenda shtetit apo jashtë shtetit, prolongimi (shtyrja zvaritja) i padrejtë i kthimit të robërve të luftës në shtetin e tyre, imponimi i aparteidit apo praktikës tjetër nënçmuese, që bazohet në diskriminim racor, sulmi në monumentet historike, në vepra artistike apo vende të tjera fetare të cilat vërehen qartë dhe të cilat paraqesin trashëgimi kulturore dhe shpirtërore të popullit, që gëzojnë mbrojtje të posaçme.

### **3.2 Dënimi i krimeve të luftës sipas Statutit të Gjykatës penale ndërkombëtare**

Në Statutin e Gjykatës Penale Ndërkombëtare, përkatësisht në nenin 5 janë paraparë katër grupe të veprave penale ndërkombëtare të cilat janë në kompetencë të gjykatës penale ndërkombëtare, si:

- a) gjenocidi ;**
- b) krimet kundër njerëzimit ;**
- c) krimet e luftës ;**
- d) krimi i agresionit.**

Dënimet të cilat mund ti shqiptojë gjykata janë të parapara në nenet 77-80. Neni 77 parasheh këto lloje të dënimeve:

- dënim me burgim deri në 30 vite, mund të shqiptohet në kohëzgjatje për disa vite por jo më shumë se tridhjetë vite;
- dënimin me burgim të përjetshëm, shqiptohet për veprat penale veçanërisht të rënda;
- dënimin me gjobë, që është i paraprë si dënim sekondar dhe shqiptohet krahas dënimit me burg.

Së bashku me dënimin me burg mund të shqiptohet edhe masa konfiskimi i pasurisë i fituar direkt apo indirekt nga vepra penale.

Konfiskimi i pasurisë nuk konsiderohet si dënim, por masë e cila konsiston në marrjen e pasurisë apo fitimit të realizuar nga vepra penale qoftë i drejtpërdrejt apo në mënyrë indirekte.

Në bazë të nenit 78 të Statutit të gjykatës, gjykata me rastin e matjes së dënimit do të marrëparasysh rrethanat personale të kryersit dhe peshën e veprës penale.

Në vijim do të paraqesim një listë të të akuzuarve të luftës, të dënuar sipas sjelljes dhe rregullave të luftës siç përcaktohet nga Gjykimet e Nurembergut pas Luftës së Dytë Botërore si dhe marrëveshjeve të mëparshme të themeluara nga Konferencat e Hagës të vitit 1899 dhe 1907, Pakti Kellogg & Briand i vitit 1928, dhe Konventat e Gjenevës të viteve 1929 dhe 1949.

Heinrich Otto Abetz (1903-1958), ambasadori gjerman në Francë, u dënua me 20 vite burgim.

Muto Akira (1883-1948), komandant i ushtrisë japoneze dhe anëtar i Shtabit të Përgjithshëm të Përgjithshëm, u dënua me vdekje.

Zlatko Aleksovski (i lindur në vitin 1960), komandanti burgut kroat, i dënuar me 7 vjet.

Ali Daeem Ali (i lindur në vitin 1940), zyrtari Baathist i Irakut, i dënuar me 15 vjet

Andrija Artuković (1899-1988), ministri kroat i Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme, Ustasha, u dënua me vdekje, por vdiq para ekzekutimit

Tariq Aziz (1936-2015), ministri i jashtëm irakian nën Saddam Hussein, dënimi me vdekje më vonë u dënua me burgim të përjetshëm ku vdiq në paraburgim.

Abdul Quader Molla (1948-2013), Një anëtar i milicisë Al-Badar gjatë luftës çlirimtare, Molla u dënua për vrasjen e 344 civilëve dhe krimeve të tjera. Ai ishte personi i parë që u ekzekutua për krimet e kryera gjatë Luftës Çlirimtare të Bangladeshit.

Abul Kalam Azad (1947) është kriminel lufte i Luftës së Çlirimit të Bangladeshit në vitin 1971. Ai ishte Razakar i parë që u dënua për krime kundër njerëzimit, përfshirë vrasjen e civilëve të paarmatosur dhe përdhunimin e kryer gjatë Luftës. Më 21 janar 2013, Azad u dënua me akuza për krimet e tij.

Aëa Mario Čerkez (i lindur më 1959), Kroat i Bosnjes dënohet me 6 vjet [15]

Ranko Česić (i lindur më 1964), serb i Bosnjes dënohet me 18 vjet

Hamed al-Bandar (1945-2007), kryetar i Irakut i dënuar me vdekje

Miroslav Bralo (i lindur më 1967), anëtar kroat i Bosnjës i "parajsës anti-terroriste" Jokers, i dënuar me 20 vjet.

Radoslav Brđjanin (i lindur në 1948), serb i Bosnjes dënohet me 32 vjet (30 ankesa në vijim).<sup>22</sup>

---

<sup>22</sup>[https://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_convicted\\_war\\_criminals#R](https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_convicted_war_criminals#R)

Pra sic shihet krimet e luftës dënohen me dënime të ndryshme, gjithashtu edhe gjykata penale ndërkombëtare parasheh dënime të ndryshme për krimet e luftes duke përfshi dënimet prej 30 vjet burgim e deri në burgim të përjetshëm.

### **3.3 Dënimi i krimeve të luftës sipas Statutit të Tribunalit të Hagës për ish Jugosllavinë**

Tribunali në Statutin e tij, përkatësisht në nenin 24 i parasheh dënimet të cilat mund ti shqiptojë kjo gjykatë. Sipas Statutit të kësaj gjykate, kolegji i shkallës së parë mund të shqiptojë vetëm dënimin me burgim. Me rastin e shqiptimit të dënimit me burg, kolegji i cili e shqipton dënimin do të marrë parasysh rrethanat siç janë: pesha e veprës dhe vetitë personale të kryesit.

Megjithatë, dënimit me burg mund ti shtohet edhe masa me të cilën kryesve të veprave penale u urdhërohet kthimi i pasurisë pronarëve të tyre. Gjykata mund ti shqiptojë këto dënime, si:

- dënim me burgim të përjetshëm;
- dënimin me burg, i cili mund të shqiptohet në kohëzgjatje për disa vite;
- dënimin me gjobë.

Trupi Gjykes i Tribunalit të Hagës i shpalli luftë Presidentit të Republikës së Serbisë Slobodan Millosheviç dhe gjeneralit Radovan Karaxhiç i cili u shpall fajtor për gjenocid në Srebrenicë dhe krime kundër njerëzimit në BiH, dhe e dënoi me 40 vjet burg.



Kompetenca teritoriale e Tribunalit të Hagës sipas Statutit të Tribunalit shtrihet në gjitha shtetet e ish Jugosllavisë. Në bazë të kësaj kompetence Tribunali akuzoi edhe pjestarë të armatës maqedone për krime luftime, përkatësisht për Shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës, të cilat ndodhën si pasojë e Konfliktit të armatosur të vitit 2001. Për këta shkelje, gjykata i akuzoi Lube Boshkoskin dhe Johan Tarçulloskin për të cilët do flitet më gjërësisht në kapitullin e fundit të këtij punimi.

### **3.4 Dënimi i krimeve të luftës sipas Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë**

Kodi penal i RM-së në nenet përkatëse i ka parapa krimet e luftës dhe dënimet për kryesit e këtyre krimeve. Sa u përket krimeve kundër njerzimit dhe gjenocidit Kodi penal i RM-së i ka të parapame në nenet 403 dhe 403a, të cilat i definojnë si krime ndërkombëtare dhe i përcakton njëjtë si Statuti i Gjykatës penale ndërkombëtare. Në vijim do të cekim se si Kodi jonë penal I rregullon çështjet të cilat kanë të bëjnë me krimet e luftës.

**Krimet e Luftës kundër vendbanimeve civile**-sipas kodit penal të RM-së, çdo person i cili në kohë të luftës, konfliktit të armatosur apo okupimit do të veprojë në kundërshtim me rregullat e së drejtës ndërkombëtare penale duke sulmuar popullatën civile, apo vendbanimet civile, personat të cilët janë të paaftë për luftë, do të zhvillohet luftë pa zgjedhur caqet, do të kryej sulme ndaj civilëve, veprime jonjerëzore, torturime, eksperimente të ndryshme biologjike apo mjekësore, konvertim në fe tjetër, detyrim për kryerje të prostitucionit, përdhunim, sterilizim të detyruar, pengimin e ndihmave humanitare, ka bërë konfiskim të pasurisë,

plackitje të popullatës etj do të dënohet për kryerjen e ndonjërës nga këto vepra penale me së paku dhjetë vjet burgim apo me burg të përjetshëm.

**Krimet e Luftës kundër të plagosurve dhe të sëmurëve**-sipas kodit penal të RM-së ai person që në kohë lufte ose konfliktit të armatosur do ti shkel rregullat e së drejtës ndërkombëtare, duke urdhëruar që të plagosurit, të sëmurët ose personeli mjekësor të vriten, torturohen, të veprojnë në mënyrë çnjerëzore me ta, do të bëjë eksperimente shkencore biologjike, mjekësore ose të tjera, transplantim të organeve ose shkaktimin e vuajtjeve të madhe ose dëmtim të integritet trupor ose shëndetit, do të shkatërojë mjetet e transportit mjekësor dhe rezervat einstitucionit mjekësor apo fetar do të dënohet me së paku dhjetë vjet burg ose me burgim të përjetshëm.

**Krimet e Luftës kundë robërve të luftës** –personi i cili do të shkel rregullat e së drejtës ndërkombëtare dhe do të urdhëroj që robërit e luftës të vriten, të torturohen, të sillen në mënyrë çnjerëzore me ta, të bëhen eksperimente biologjike, mjekësore ose eksperimente tjera shkencore, transplantimin e organeve, , dëmtimin e integritet trupor ose shëndetësore, shkaktimin e vuajtjeve të mëdha trupore, detyrimin e robërve të luftës që të shërbejnë në forcat e armikut ose janë të privuar nga e drejta e tyre për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm apo ekzekutimin pa aktgjykim të bazuar në procedurë ligjore, ai do të dënohet me burgim prej dhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

**Keqpërdorim i armëve kimike dhe biologjike**-personi cili do të prodhojë, shesë ose të blejë, ose personi i cili dotë ndërmjetësojë në blerjen ose shitjen transporton armë kimike ose biologjike apo ndonjë lloj materiali tjetër luftarak të o cili është i ndaluar nga rregullat e së drejtës ndërkombëtare, do të dënohet me burgim prej tre

muaj deri në tre vjet, ndërsa ai që në kohë lufte ose gjat konfliktit të armatosur do të urdhëroj përdorimin e armëve kimike apo biologjike ose do të luftoj në një mënyrë që është e ndaluar nga rregullat e ndërkombëtare do të dënohet me burgim më së paku një vit, ndërsa në qoftë së gjatë kryerjes së ndonjëres nga veprat e përmendura do të sjellë vdekjen e më shumë personave atëherë kryerësi do të dënohet me më pak pesë vjet burgim apo me burg të përjetshëm.

## **Kapitulli IV**

### **4.1 Krimet e kryera gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001 në territorin e RM-së**

Deri te konflikti i armatosur i vitit 2001 erdhi nga pakënaqësia e shqiptarëve të cilët u moheshin të drejtat e tyre, të cilat dita ditës po shkileshin nga ana e palës maqedonase. Shqiptarët ishin ata të cilët keqtrajtoeshin, malltretoeshin, duke i konsideruar ata një pakicë ndaj të cilëve mundë të bëjnë gjithcka, sikur ato kishin të drejtë mbi ata për të ushtruar cdo lloj të drejte, dhune apo malltretimi.

Shqiptarët nga padrejtësia që u bëhej vendosen që të ngriten dhe të kërkojnë të drejtat e tyre të barabarta me maqedonasit, që Maqedonia të funksionojë si një shtet multietnik.

Provokimet e shumta që bëheshin nga ana e palës maqedonase gjithashtu sollën edhe deri te konflikti i armatosur i vitit 2001, së pari vendosja e kryqit në Kalanë e Tetovës nga ana e pakicës maqedonase ishte shenjë që të tregonin se shteti i Maqedonisë është shteti i tyre dhe ata mundë të bënin çfarë të donin, policia maqedonase gjithashtu vepronte brutalisht bënte fyerje, arestime të pa drejta dhe keqtrajtime në burgje popullatës shqiptare ku coi ala më shumë deri te urrejtja nacionale.

Policia maqedonase gjithashtu filloi të ushtronte dhunë nëpër fshatrat e Tetovës të banuar me shqiptarë në Shemshovë, Grupcinë, Tearcë, Nerashtë, Poroj, duke bastisur shtëpit e tyre, ku mallteroheshin familjet shqiptare, dhe disa rriheshin brutalisht nga ana e policisë.

Për disa javë apo muaj, popullata e Tanushës, Malësisë së Tetovës, popullata e komunës së Likovës (Sllupcanit , Vaksincës, Orizarës, Hotlës, Matecit, Opajës etj), më vonë edhe ajo e komunës së Haracines, mbeten të ngujuara nëpër podrume, sepse forcat e armatosura të Maqedonisë kanë filluar një luftë të pakompromis në përgjithësi kundër shqiptarëve në Maqedoni.<sup>23</sup>

Shkaku i shpërnguljes së 60 familjeve shqiptare nga Tanusha për në Viti të cilët malltreshin brutalisht nga ana e ushtarëve të Maqedonisë solli deri te përleshja e 3 orëshe e ushtrisë maqedonase dhe shqiptarëve e cila ishte fillimi I luftës së UCK-së. Luftimet e para midis forcave të armatosura të UCK-së dhe forcave ushtarake-policore maqedonase, u zhvilluan më 16 shkurt 2001, në fshatin Tanushë të malësisë së Shkupit.<sup>24</sup> Pas këtyre ngjarjeve në Mars të vitit 2001, filloi lufta në zonën e Malësisë së Sharrit dhe në rrethinat e Tetovës e cila kishte rëndësi të madhe për shumë arsye ku do të përmendim:

-kjo luftë paralajmëroi se pakënaqesia kishte përfshirë gjithë popullatën shqiptare dhe se problemet e grumbulluara çuan në luftë, e jo ndonjë gjë tjetër e jashtme, sic u pretendua ka politika maqedonase.

- uli shkallën e veprimit të policisë në zonën e fshatrave të Kumanovës duke bërë angazhimin e forcave të tjera në Malësinë e Sharrit.

- bëri hapjen e forcave policore dhe ushtarake në teren dhe krijoi kushte të volitshme për zbulim dhe marjen e një vendimi sa më të drejtë nga Shtabi i Përgjithshëm për rifillimin e luftës në këto anë, ku do të krijohet sipas planit, Brigada 112 Mujdin Aliu.

---

<sup>23</sup> Mair A. Iseini, Zhvillimet në Maqedoni dhe lindja e UCK, fq, 65

<sup>24</sup> Salih Salihu, Ngjarje dhe dëshmi, fq 163

- u pa gatishmëria dhe angazhimi i popullatës në këto zona, për përkrahjen e luftës dhe u pa se ki popull e donte lirinë si gjënë më të shtrenjtë duke përkrahur UCK-në që në momentin e parë të fillimit të veprimeve luftarake.

- krijoi një eksperiencë të pa pasur më parë për organizimin, vendosjen dhe mënyrën e zhvillimit të luftës.

-pavarësisht nga humbjet e para që janë të justifikueshme në një luftë popullore, krijoi besim se kundër ushtrisë dhe policisë sllavo-maqedonase mundë të luftohej e të fitohej po të ishte mir i organizuar e i armatosur mirë.<sup>25</sup>

Mëdyshja a ishte konflikt apo luftë ende qarkullon dhe është objekt debati në të gjitha fushat shkencore duke filluar nga niveli më i ulët deri tek ai më i lartë akademik që është në kuadër të institucioneve të arsimit sipëror dhe jashtë tyre, në tryeza të ndryshme shkencore e politike e deri te shtresat e rëndomta popullore nëpër mjedise të ndryshme publike dhe familjare.<sup>26</sup>

## **4.2 Krimet e luftës të kryera në territorin e RM-së në vitin 2001**

Në Maqedoni filloi procesi gjyqësor për 4 raste që kishin të bëjnë në lidhje me konfliktin e armatosur të vitit 2001, këto 4 raste ishin:

1. Udhëheqësia e UCK-së-ky rast kishite të bëjë me akuzimin e dhjetë udhëheqësve të UCK-së, për përgjegjësi komande lidhur me krime lufte duke u thirur në ndodhitë në Vejcë.

---

<sup>25</sup> Petrit Mënaj, Shqiptarët në Maqedoni dhe lufta, fq 66, Tetovë 2012

<sup>26</sup> Fejzulla Arifi, Lufta e diplomacies, Shkup 2016

2. Sabotimi i ujësjelljes së qytetit të Kumanovës-ky rast i dytë akuzon komandat të UCK-së për mbylljen e ventilave të ujit në Kumanovë gjatë verës të vitit 2001.
3. Malltretim i puntorëve të Mavrovës- rasti i tretë u referohet anëtarëve të UCK-së, që kanë rrahur pesë puntorë, të ndërmarrjes ndërtimore Mavrova në rrugën Shkup-Tetovë
4. Neproshteni- rasti i katërt i referohet anëtarit të UCK-së, lidhur me zhdukjen e disa personave në Trebosh ku thuhet se këta civilë janë të vrarë dhe janë varosur në varezë masive.

Këta raste të cilat i përmendëm më lartë janë raste të cilat u barten në Tribunalin Ndërkombëtare për ish-Jugosllavin, të cilat u bartën në TNPJ sipas kërkesës së PPSH në vitin 2002.

TNPJ filloi hetimet për të gjithë rastet e paraqitura plus 1 rastin e Lubotenit për të cilin akuzoheshin Boshkovski dhe Tarculovski, mirpo TNPJ i shqyrtoi të gjitha rastet dhe ngriti akuzë vetëm për njërin rast, ajo ngriti akuzë në dhjetor 2004 kundër Boshkovskit dhe Tarculovskit.

Për 4 rastet tjera të sipërpërmendura TNPJ nuk gjeti prova të mjaftueshme për të ngritur akuzë për këto raste, u kthyen në Maqedoni për gjykim të mëtejshëm dhe në vitin 2011 u përfshin në Ligjin për amnisti të vitit 2002 si pjesë e marrveshjes politike.

### **4.2.1 Rasti i Lubotenit**

Pra siç cekëm më lartë për këtë rast u akuzuan Boshkovski dhe Tarculovski ku TNPJ ngriti akuzë për sa i përket këtij rasti. Boshkovski dhe Tarculovski u akuzuan për krime lufte, ku akuza mbështetej në tri baza:

- Vrasja e 7 civilëve shqiptarë në Ljuboten
- Shkatërrimi me qëllim i vendbanimit (14 shtëpi në Ljuboten u shkatërruan tërësisht ose pjesërisht)
- Sjellje johumane me të kapurit në Ljuboten

Ekstradimi i të akuzuarve u bë në Mars të vitit 2005, ndërsa gjykimi filloi në prill 2007, akuza e kompletoi rastin e vetë në dhjetor 2007 kurse mbrojtja e filloi rastin në janar 2008. Më datë 10.06.2008 Boshkovski lirohet, ndërsa Tarculovski dënohet me 12 vjet burgim.

Në maj të vitit 2010 mbaron gjykimi i apelit dhe afirmohet vendimi i 2008, ndërsa në vitin 2011 Tarculovski transferohet në Gjermani për vuajtje të dënimit dhe në vitin 2013 Tarculovski lirohet para mbarimit të dënimit.

### **4.3 Personat e akuzuar për krime lufte në konfliktin e armatosur të vitit 2001**





Lube Boshkoski            Johan Tarçulovski

*(Teksti i mëposhtëm është i nxjerrë nga faqja zyrtare e Tribunalit të Hagës)*

## **Aktakuza**

Prokuroria e Tribunalit kundër Lube Boshkoskit dhe Johan Tarçulloskit.

### **Aktakuza e ndryshuar për herë të dytë**

Prokuroria e Tribunalit Penal Ndërkombëtarë për ish-Jugosllavinë, në bazë të kompetencave të saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit penal Ndërkombëtarë për ish-Jugosllavinë akuzon:

#### **Lube Boshkoskin**

#### **Johan Tarçulloskin**

**Për SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, si parashtrohen më poshtë.**

#### **TË AKUZUARIT**

#### **LUBE BOSHKOSKI**

1. **Lube Boshkoski** u lind më 24 tetor 1960, në qytetin e Tetovës të Republikës së Maqedonisë -Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë, (“FYROM”). Nga maji 2001 deri në nëntorë 2002, Lube Noshkoski ishte Ministër i Brendshëm i FYROM-it. Në atë kohë ai ishte anëtarë i shquar i Organizatës së Brendshme Revulicionare Maqedonase – Partisë Demokratike për Bashkimin Kombëtar Maqedonas (“VMRO-DPMNE”).

2. **Johan Tarçulloski** u lind më 17 nëntorë 1974 në qytetin e Shkupit në Republikën e Maqedonise të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë. Në 2001 ai ishte oficer policor dhe punonte si Inspektor Përcjellës në Trupën e Sigurimit të Presidentit. Ndër të tjera detyr e tij ishte sigurimi personal i presidentit. Gjithashtu ai ishte anëtarë i VMRO-DMNE-së.

### **PERGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE**

3. **Johan Tarçulloski** si individ është penalisht përgjegjës bazuar në Nenin 7(1) të Statutit të Tribunalit për krimet e përmendura në Nenin 3 të Statutit të Tribunalit siç deklarohet në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë, të cilat ai i kreu, urdhëroi, nxiti ose ndihmoi në kryerjen e tyr. Me përdorimin e fjalës “kreu” " në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë, Prokurorja nuk pretendon se I akuzuari kreu fizikisht ndonjë prej krimeve të akuzuara. "Kryerje" në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë përfshin pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkë tkriminale ("NPK").

4. NPK-ja filloi ekzistencën e saj jomëparë se e premtja e 10 gushtit 2001 dhe vazhdoi deri më dhe duke përfshirë të dielën 12 gusht 2001 gjate konfliktit të armatosur në FYROM. Objektivi iNPK-së ishte të drejtonte një sulm të paligjshëm mbi civilë dhe objekte civile në fshatin Luboten, që nuk ishte i justifikueshëm prej domosdoshmerisë ushtarake sipas Nenit 3 të Statutit të Tribunalit. Krimet që ndodhën në Luboten dhe që janë akuzuar në Pikat 1 dhe 3 të Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë përfshiheshin brenda objektivit të NPK-së.

6. Midis së premtes 10 gusht 2001 deri më dhe përfshirë të dielën, 12 gusht 2001, Johan Tarçulloski mori pjese ne NPK duke qenë në dijeni të objektivit të paligjshëm, gjatë tërë ekzistencës së saj në një ose më shumë prej mënyrave të mëposhtme:

(a) Ai zgjodhi personalisht individë për formimin e njësisë së tij me police të rregullt dhe rezervistë që mori pjesë në sulm.

(b) Ai bashkërendoi armatosjen e anëtarëve të njësisë së tij me police të rregullt dhe rezervistë që mori pjesë në sulm.

(c) Me ndihmën e zyrtarëve të lartë qeveritarë dhe policorë, ai bindi komandantët më të lartë policorë dhe ushtarakë përgjegjës për sigurinë në rajonine Lubotenit që të mbeshtesnin sulmin kundër Lubotenit.

(d) Ai kërkoi dhe mori mbështetje logjistike, material dhe me arme zjarri për sulmin kundër Lubotenit nga komandantët më të lartë policorë dhe ushtarakë të bazuar në rajonine Lubotenit.

(e) Ai inxiti policët e rregullt dhe rezervistë në njësinë e tij që të mermin pjesë në sulmin kundër Lubotenit.

(f) Ai vendosi për armatimin, forcat, mbështetjen logjistike dhe mbështetje tjetër material që do të përdorej në sulm.

(g) Ai përcaktoi kohën, metodën, mënyrën, qëllimet dhe caqet e sulmit.

(h) Duke shfrytëzuar pozitën e pushtetit të tij, ai urdhëroi policët erregullt dhe rezervistë në njësinë etij të sulmonin Lubotenin.

(i) Ai ishte ipranishëm dhe udhëhoqi e drejtoi personalisht në sulmin tokësor dhe ishte i pranishëm në vendet e krimeve të veçanta të akuzuara në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë

5. **Lube Boshkoski** si individ është penalisht përgjegjës bazuar në Nenin 7(3) të Statutit të Tribunalit për krimet e përmendura në Nenin 3 të Statutit të Tribunalit siç deklarohet në Aktakuzën e Ndryshuar për Herë të Dytë. **Lube Boshkoski** ngarkohet me përgjegjësinë e eprorit për krimet e policies së rregullt dhe rezervistë, përfshirë njësitë e policisë speciale, sipër kryerjen e krimeve prej atyre policeve poashtu edhe për veprimet apo mosveprimet e këtyre policeve, që ndihmuan rojet e burgut, punonjësit e spitalit dhe civilë të kryenin ato krime që pershkruhen në pikat e Aktakuzës së Ndryshuar për Herë të Dytë. Eprori është përgjegjës për veprimet kriminale të vartësve të vet në qoftë se ai dinte ose kishte arsye të dinte se vartësit e tiji shin në prag të kryerjes së këtyre veprimeve ose I kishin kryer dhe eprori nuk morimasa të nevojshme dhe tëa rsyeshme për parandalimin e veprimeve të tilla ose për dënimin e keqbërësve. **Lube Boshkoski** nuk përmbushi detyrën si epror për hetimin dhe ndëshkimin e kryersve të krimeve që pretendohen mëposhtë.

6. **Lube Boshkoski** në cilësinë si Ministër I Brendshëm ushtronte komandë dhe kontroll *de jure* dhe *de facto* mbi forcat policore që morën pjesë në krimet e akuzuara në Aktakuzën e Ndryshuar për Herëtë Dytë. **Lube Boshkoski** si Ministër I Ministrisë së Brendshme të FYROM-it ("MB") ishte autoriteti më i lartë në MB. Zyrtarisht ai ishte përgjegjës edhe për sigurines htetërore dhe publike. Në cilësinë si Ministër i MB-së së

FYROM-it, **Lube Boshkoski** kishte përgjegjësi dhe pushtet të gjithanshem për funksionimin e forcave policore si të rregullta po ashtu edhe rezerviste, përfshirë të tëra njesitë e policies special Brenda FYROM-it.

Të akuzuar për:

1. Vrasje;
2. Shkatërim pa shkak;
3. Trajtim mizor.

Sipas prokurorisë së Tribunalit Lube Boshkoski dhe Johan Tarçulloski kanë bërë shkelje të :

- **LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS** - Trajtim Mizor, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Neneve 3 dhe 7(1) të Statutit të Tribunalit.

Duke marrë parasysh të gjitha provat u mor vendimi që i akuzuari Lube Boshkovski të shpallët I pafajshëm për të gjitha pikat e aktakuzës dhe u urdherua lirimi i Lube Boshkovskit nga paraburgimi.

Kurse Johan Tarculovski u shpallë fajtorë për sa I përket këtyre pikave:

Pika 1: Vrasje, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e vrasjeve të Rami Jusufit, Sulejman Bajramit dhe Muharem Ramadanit;

Pika 2: Shkatërrim pa shkak, shkelje e ligjeve apo zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e shkatërrimit pa shkak të shtëpive ose pronave të tjera të Alim Durakit, Agim Jusufit, Qenan Jusufit, Sabit Jusufit, Xhevdet Jusufovskit, Abdullah Luftiut, Harun Rexhepit, Ismet Rexhepovskit, Nazim Murtezanit, Qani Jasharit, Afet Jasharit dhe Ramush Jasharit;

Pika 3: Trajtim mizor, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e trajtimit mizor në shtëpinë e Adem Ametovskit të M012, Hamdi Ametovskit, Adem Ametovskit, Aziz Bajramit, M017, Nevaip Bajramit, Vehbi Bajramit, Atulla Qailit, Beqir Ramadanit, Ismail Ramadanit, Muharem Ramadanit, Osman Ramadanit, dhe Sulejman Bajramit; si dhe trajtim mizor në shtëpinë e Bracës të M012, Hamdi Ametovskit, Adem Ametovskit, Nevaip Bajramit, Vehbi Bajramit, Atulla Qailit, Beqir Ramadanit, Ismail Ramadanit, dhe Osman Ramadanit;

Johan Tarculovski u dënua vetëm me dymbëdhjetë vjet burg, dhe u ekstradua në gjermani për vuajtjen e dënimit. Johan Tarculovski u lirua nga burgu në vitin 2013 pas mbajtjes së dy të tretës së dënimit pra pas tetë vjet burgimi ai u lirua nga Gjykata Penale Nërkombëtare për ish Jugosllavinë.

## Përfundimi

E drejta penale ndërkombëtare synon njohjen, me mekanizmat juridike dhe institucionalë me të cilët, realizohet ndëshkimi i autorëve të veprave penale me element ndërkombëtarë, si dhe garantohet bashkëpunimi ndërmjet shteteve në lufte kundër kriminalitetit ndërkombëtar. Pjesë e së drejtës penale ndërkombëtare është edhe jurisprudenca penale ndërkombëtare, themelimi, organizimi si dhe parimet e funksionimit dhe vendimarrjes së gjykatave penale ndërkombëtare. Një vënd të rëndësishëm zënë edhe normat penale me anë të të cilave rregullohet ndihma e ndërsjelltë dhe bashkëpunimi midis shteteve në parandalimin dhe ndëshkimin e veprave penale me elementë ndërkombëtar.

Bashkimi Evropian (BE) është një mbështetes kryesor në sferën politike, juridike, financiare, teknike dhe një përkrahës i Gjykatës Penale Ndërkombëtare dhe gjykatave të tjera ndërkombëtare. Mbështetja e BE-së ndaj GJPN-së mund të konsiderohet si “një nga spirancat simbolike të politikave të jashtme të BE-së, në harmoni të plotë me vlerat përcaktuese të BE-së.” Vendosmëria e BE-së për parandalimin e krimeve që përbëjnë shqetësim ndërkombëtar dhe marrja fund e mosndëshkueshmërisë për autorët e krimeve të tilla është duke u bërë më e dukshme edhe me vendet të cilat synojnë të integrohen në BE. Krimet e rënda nën juridiksionin e GJPN-së kërcënojnë paqen, sigurinë dhe mirëqenien e botës siç theksohet në Preambulën e Statutit të Romës. Sikurse ndodh me grupet e ndryshme rajonale brenda sistemit të GJPN-së, Shtetet Anëtare të Bashkimit Evropian (BE) janë të angazhuara për të bashkëpunuar për parandalimin e krimeve nën

juridiksionin e GJPNsë dhe për t'i dhënë fund mosndëshkimit të autorëve të krimeve.

Lufta e 2001 në Maqedoni erdh si pasojë e shkeljes së çështjes shqiptare (shkelja e të drejtave së popullsisë shqiptare), ku për fat të keq sot e kësaj dite ende nuk janë të rregullume me ligje përkatëse si p.sh., ligji për përdorimin zyrtarë të gjuhës shqipe në institucionet kyçe të shtetit, p.sh. në gjykat. Një numër i madh i krimeve të luftës, si vrasje, shkatërime të shtëpive, shkatërime të objekteve fetare në luftën e 2001 në Maqedoni mbetën jetim, pasi që nuk u akuzua dhe dënua askush për këta krime. Megjithatë, është për tu përshëndetur puna e gjykatës së Hagës e cila bëri të pamundurën, me qëllim që të dalin para drjtësisë aktorët e krimeve të tilla, ku akuzoi dy prej tyre, Lube Boshkoskin i cili ishte Ministër i Punëve të Brendshme në kohën e luftës dhe Johan Tarçulloskin i cili u dënua me 12 vite burgim për shkelje të ligjeve dhe zakoneve të luftës.

Përfundimisht, mund të them se roli i gjykatës ka qenë dhe do të jetë më se i rëndësishëm për dënimin e personave që kanë kryer krime të luftës dhe të njejtët të mos i lejojë që të mbeten pa u dënuar. Dorëzimi i kriminelëve duhet bërë pa hezitim, duke mos iu dhënë atyre të drejtën e azilit politik.

Secili shtet ka për obligim që të bashkëpunojë me gjykatën në mënyrë të veçantë, me qëllim që asnjë autor i veprave penale me karakter ndërkombëtar të mos mbetet i pa dënuar për krimet e bëra në kohë lufte apo paqe.

Shpresoj, që në të ardhmen të punohet më shumë në këtë segment, të ketë më shumë bashkëpunim dhe ndihmë ndërmjet shteteve në mes veti, si dhe ndërmjet shteteve dhe gjykatave ndërkombëtare.



## Konkluzë dhe rekomandime

- Tribunali Ndërkombëtar për Ndjekjen Penale të Personave Përgjegjës për Shkelje të Rënda të së Drejtës Humanitare Ndërkombëtare të Kryera në Territorin e ish Jugosllavisë prej Vitit 1991, akuzon të Akuzuarit, Lube Boshkoski dhe Johan Tarçulovski, për krime të kryera kundër shqiptarëve etnikë në fshatin Luboten, në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë, nga 12 deri më 15 gusht 2001. Aktakuza pretendon se më 12 gusht, fshati Luboten u bë objekt i një sulmi të përbashkët nga policia e drejtuar prej Johan Tarçulovskit, si dhe nga ushtria e RM-së. Pretendohet se gjatë sulmit policia vrau gjashtë banorë të Lubotenit
- Aktakuza akuzon të Akuzuarit për tri pika të shkeljeve të ligjeve apo zakoneve të luftës, konkretisht, vrasje, trajtim mizor, dhe shkatërrim pa shkak, në bazë të Nenit 3 të Statutit.
- Lube Boshkoski, Ministër i Brendshëm (“MB”) i RM-së nga maj 2001 deri në nëntor 2002, akuzohet për përgjegjësi individuale penale në bazë të Nenit 7(3) të Statutit. Pretendohet se, si epror, ai ka përgjegjësi penale për krimet e policisë së rregullt dhe rezerviste, duke përfshirë njësitë e posaçme të policisë; pra, si për kryerjen e krimeve nga këto forca policore, po ashtu dhe për veprimet apo mosveprimet e atyre policëve që ndihmuan dhe nxitën rojet e burgjeve, personelin e spitaleve, dhe civilët për kryerjen e krimeve të përfshira në Aktakuzë.

- Johan Tarçulovski, në atë kohë polic me detyrën e Inspektorit Shoqërues në Trupën e Sigurimit të Presidentit, në Ministrinë e Brendshme, akuzohet për përgjegjësi individuale penale në bazë të Nenit 7(1) të Statutit, për pjesëmarrje në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (“NPK”), nga 10 deri më 12 gusht 2001, qëllimi i së cilës pretendohet se ishte kryerja e një sulmi të paligjshëm kundër civilëve dhe objekteve civile në fshatin Luboten, sulm i cili nuk justifikohet prej domosdoshmërisë ushtarake, gjë që përbën krim në bazë të Nenit 3 të Statutit. Pretendohet se ai bashkëpunoi me anëtarë të njohur dhe të panjohur të NPK-së në forcat e rregullta dhe rezerviste të policisë së RM-së, të cilët ishin nën komandën e tij në MB.
- Gjykata e Hages NË DHOMËN GJYQËSORE II Para: Gjykatësit Kevin Parker, Kryegjykatës Gjykatëses Christine Van Den Eyngaert Gjykatësit Krister Thelin Sekretari: Z Hans Holthuis me Aktgjykimin e datës: 10 korrik 2008, e shpall të Akuzuarin Lube Boshkoski TË PAFAJSHËM për të gjitha pikat e Aktakuzës. Në bazë të dispozitës 99(A) të Rregullores, Dhoma urdhëron lirin e Lube Boshkoskit nga Njësia e Paraburgimit të Kombeve të Bashkuara menjëherë pas kryerjes së formaliteteve të nevojshme.
- Në bazë të Nenit 7(1) të Statutit, Dhoma e shpall të Akuzuarin Johan Tarçulovski FAJTOR për pika e mëposhtme: Pika 1: Vrasje, shkelje e ligjeve ose zakoneve të luftës, sipas Nenit 3 të Statutit, për urdhërimin, planifikimin dhe nxitjen e vrasjeve të Rami Jusufit, Sulejman Bajramit dhe Muharem Ramadanit;

- Organizata për të drejtat e njeriut “Amnesty International” e ka paralajmruar Maqedoninë që të ndajë drejtësi dhe ti kompensoj viktimat e luftës së vitit 2001, duke u bazuar në të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe të drejtat e njeriut.
- Gjithashtu kërkohet që Maqedonia në pajtim me të drejtën ndërkombëtare të paguaj reparacione (dëmshpërblime lufte) për krimet të cilat kanë ndodhur gjatë konfliktit të vitit 2001, ka njoftua agjencia e lajmeve INA.
- Sipas raportit të kësaj organizate, këtu duhet të përfshihen edhe viktimat e krimeve të luftës si dhe familjarët e të zhdukurve, të cilët nuk kanë qasje në drejtësi.
- Megjithëse një numër i madh shqiptarësh kanë humbur jetën gjatë konfliktit të armatosur të vitit 2001, ndërsa fati i shumë të tjerëve nuk dihet edhe sot e kësaj dite, 17 vjet pas konfliktit, subjektet politike shqiptare në Maqedoni nuk e kanë parë të arsyeshme të marrin një nismë që ka për qëllim zbardhjen e fakteve të kësaj lufte dhe trajtimin institucional të viktimave dhe të zhdukurve.

## Bibliografia

- Jola Xhafo, *E drejta penale ndërkombëtare*, Tiranë 2012
- [https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1\\_rul\\_rule156](https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1_rul_rule156)
- *Kodi Penal I Rm-së*
- Ismet Salihu, *E drejta penale ndërkombëtare*, Prishtinë 2005
- [http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Konventat\\_e\\_Gjeneves.pdf](http://www.punetejashtme.gov.al/files/userfiles/Konventat_e_Gjeneves.pdf)
- <http://www.infocip.org/al/?p=6641>
- *Elementet e krimeve, Gjykata penale ndërkombëtare*, 2011. Publikuar nga Gjykata penale ndërkombëtare ISBN Nr 92-9227-232-2, fq 5
- Margaret M. DeGuzman, "Crimes Against Humanity" RESEARCH HANDBOOK ON INTERNATIONAL CRIMINAL LAW, Bartram S. Broën, edited., Edgar Elgar Publishing, 2011
- Ilias Bantekas and Susan Nash, *International criminal law, Third edition*
- Kriangsak Kittichaisare, *International criminal law, Oxford*
- Robert Cryer, Hakan Friman, Darryl Robinson, Elizabeth Wilmshurst, *An introduction to criminal law and procedure, Second edition*
- Antonio Cassese, *International criminal law, Oxford*
- [https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1\\_rul\\_rule156](https://ihl-databases.icrc.org/customary-ihl/eng/docs/v1_rul_rule156)
- [https://en.wikipedia.org/wiki/List\\_of\\_convicted\\_war\\_criminals#R](https://en.wikipedia.org/wiki/List_of_convicted_war_criminals#R)
- Shtetet Palë, *Nënshkruesit e Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949, E drejta ndërkombëtar humanitare*, Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq. Marrë 22-01-2007(ëikipedia) fq.2

- *ëipo.int, Konventa e Gjenevës në lidhje me mbrojtjen e personave civilë në kohë Luftë, 12 gusht, 1949, (ëikipedia), fq.2*
- *Kodi Penal i RM-së, - <http://www.pravda.gov.mk>*
- *Petrit Mënaj, Shqiptarët në Maqedoni dhe lufta, Tetovë 2012*
- *Mair A. Iseini, Zhvillimet në Maqedoni dhe lindja e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare, Cabej 2002.*
- *Salih Salihu, Ngjarje dhe dëshmi ,Tetovë 2012*
- *Fejzulla Arifi, Lufta e diplomacisë, Shkup 2016*
- *Konventa e Gjenevës për përmirsimin e fatit të të plagosurve dhe të sëmurve të forcave të armatosura në luftë(Konventa e Gjenevës nr I)*
- *Konventa e Gjenevës për përmirsimin e fatit të të plagosurve të sëmurve dhe anijeve të përmytura të forcave të armatosura detare (Konventa e Gjenevës nr II)*
- *Konventa e Gjenevës lidhur me sjelljen ndaj robërve të luftës(Konventa e Gjenevës nr III)*
- *Konventa e Gjenevës për mbrojtjen e personave civilë gjatë kohës së luftës(Konventa e Gjenevës nrIV)*
- *Protokolli I u referohet mbrojtjes së viktimave të konflikteve të armatosura kombëtare*
- *Protokolli II u referohet konflikteve të armatosura të mbrendshme, Brenda një shteti.*
- *Statuti i Tribunalit penal ndërkombëtarë për ish Jugosllavinë (Tribunali i Hagës), 1993, i plotësuar më vitin 1998 dhe Tetor të vitit 2000.*